



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.901/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada -Glllogjani dhe Adnan Konushevi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë në Kuvend Komunal në Lipjan, Besnik Hajrizi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvend Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.901/2021 i datës 04.11.2021 paraqitur nga kandidati për anëtarë për Kuvend Komunal në Lipjan, Besnik Hajrizi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet vetëm për Kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan nga Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në Vendvotimet VV 1326E/02D, VV 1307E/07R, VV 1301E/01R, VV 1301X/04R në Komunën e Fushëe Kosovës.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimit si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

IV. IV Refuzohet i pabazuar apeli Anr.901/2021 i datës 04.11.2021, i kandidati për anëtarë për Kuvend Komunal në Lipjan, Besnik Hajrizi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, në pjesën me të cilën ka kërkuar rinumërimin e vendvotimeve VV 1301E/04R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë për Kuvend Komunal në Lipjan, Besnik Hajrizi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, në të cilën pretendon se në vendvotimet VV 1326E/02D, VV 1307E/07R, VV 1301E/01R, VV 1301X/04R dhe VV 1301E/04R sipas FPR se është dëmtuar në bartje të votave nga anëtarët e Këshillit të vendvotimit dhe nuk ka marë vota ndërsa sipas dëshmitarëve dhe vëzhguesve ka vota në këto vendvotime. Si dëshmi krahas apelit i ka bashkangjitur deklaratatë të dëshmitarëve përkatësisht votuesve të tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton kandidati për anëtarë për Kuvend Komunal në Lipjan, Besnik Hajrizi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në Venvotimet VV 1326E/02D, VV 1307E/07R, VV 1301E/01R, VV 1301X/04R, në komunën e Lipjanit.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimeve si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, pasi që mbështetet edhe në prova të dorëzuara nga kandidati, ku shihet se nga deklaratat e gjithsej njëmbëdhjetë votuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës me deklarinimin se në vendvotimet: VV 1326E/02D ka 2 vota, VV 1307E/07R ka 1 votë, VV 1301E/01R ka 1 votë dhe në VV 1301X/04R ka 2 vota. Gjithsej vota në këto vendvotime kanë rezultuar 2 vota derisa nga deklaratat e dëshmitarëve ishte dashur të jenë se paku 8 vota.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitim të kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se kandidati për anëtarë për Kuvend Komunal në Lipjan, Besnik Hajrizi nga Subjekti Politik LDK, me tw cilwn kërkon rinumërimin e votave për vendvotimin VV 1301E/04R është i pa bazuar për faktin se për të njëjin vendvotim, KQZ-ja veç e ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtin vendvotim të rinumëruar nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshëm.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.901/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit

Ferki Xhaferi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

